



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

**Notere Mimoza R.Shehu**

*Taksa e pulles u pagua*

**Rruga "Abdyl Frasheri" Pll/3/3**

**studi\_shehu@yahoo.com**

**Nr. Rep.** \_\_\_\_\_

**Nr. Kol.** \_\_\_\_\_

### **AKT THEMELIMI**

#### **I FONDACIONIT 'AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE RRËNJËT TONA'**

Sot me daten \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019 zyrën e Noterisë Tiranë, përpara meje Noteres Mimoza Shehu, Notere e Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne adrese Rruga «Abdyl Frasheri» Pll.3.3 u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte :

Z. Sazan Guri, atesia Ilmi, lindur me 11.12.1956 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F612110530.

Z. Stefan Pinguli, atesia Dhimiter, lindur me 27.12.1953 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F31227042L

Z. Frederik Balaj, atesia Ali, lindur me 26.12.1960 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal G01226034N.

të cilët bien dakord për sa më poshtë:

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Emri dhe statusi juridik i Fondacionit**

- a) Emërtimi i fondacionit është **"Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona"**
- b) FONDACIONI 'Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona' do të përdorë si simbol identifikues shkurtimin e emrit të saj në gjuhën shqipe, "ARRT"



- c) ARRT zhvillon veprimtarinë e saj e saj në të gjitha trevat e kombit tonë dhe kudo ku ndodhen shqiptarë (të diasporës së re dhe të vjetër).
- d) ARRT ka stemën dhe vulën e saj. Stema dhe vula përdoret vetëm nga personat e autorizuar.
- e) ARRT është një organizatë akademiko-social-kulturore, institucion i specializuar, jo-qeveritare, jo-politike, jo-fitimprurëse.

## **Neni 2**

### ***Selia***

Selia për “Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona - ARRT” ndodhet në Tiranë, Rr. Zef Jubani, Pall. Bjorn, Ap 62, k-8, Tiranë, Shqipëri.

## **Neni 3**

### ***Stema e fondacionit***

Si stemë e ARRT do të jetë: Shqiponja e stilizuar me bririn e dhisë amalthea e Skënderbeut.

## **Neni 4**

### ***Kohëzgjatja***

Fondacioni do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar,

## **Neni 5**

### **Metoda e veprimtarisë së Fondacionit**

- a. Puna dhe veprimtaria e fondacionit është e hapur për publikun.
- b. Transparenca e veprimtarive sigurohet me përgatitjen e raporteve të rregullta mbi punën e grupimit, si dhe publikimin e tyre në një web-site të fondacionit.
- c. Qëllimi i Fondacionit është që të ngrëjë një “INSTITUCION TË SPECIALIZUAR”, të emërtuar Akademia Shkencore Alternative “RRËNJËT TONA”, veprimtaria e së cilës do të përfshijë parashtrimin dhe rishikimin e fakteve historike, gjuhësore dhe etnokulturore të hulumtuara deri më sot dhe prurjet e reja nga studiues të ndryshëm, mbi vijëmësinë e shqipes së sotme nga gjuhët e lashtësisë, aotoktoninë në trevat e tyre dhe vazhdimësinë e pandërprerë të historisë sonë, si dhe t’iu tregojë shqiptarëve faktet shkencore të qëniers si banorë e si popull natyral të europës së lashtë.
- d. Veprimtaria e Fondacionit do të realizohet nëpërmjet projekteve të afuara nga sektorët përkatës shkencorë.

## **Neni 6**

### ***Objekti i Veprimtarisë së Fondacionit***



Veprimtaria e Fondacionit 'Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona' në kuptimin juridik, dhe/ose atij të specializuar në kuptimin shkencor do të përqëndrohet në këto fusha:

- a. Historiografi, Gjuhësi, Etnokulturë, Ekonomi patriotike, Turizëm historik dhe Inxhinieri dhe degë të tjera që lidhen me shkencën Albanologjike për të cilat do të ketë departamente më vete operimi dhe pune, me qëllim informimin dhe vënien në dispozicion të subjekteve të ndryshëm shtetërorë e privatë, të publikut të gjerë, vendas e të huaj e të organeve të pushtetit qendror e lokal, studime, projekte dhe konsulta në fushat e mësipërme që do t'iu shërbejnë atyre për të hartuar programe zhvillimi afatshkurtëra, afatmesëm e afatgjata.
- b. Fondacioni, si Institucion i specializuar me departamentet e saj, e organizuar në nivel Akademi alternative do të sjellë fakte e interpretime, sesi mund të ndihmojë historia për të siguruar lirinë e vërtetë të mendimit dhe të shprehjes dhe të bëhemi pjesë dinjitoze e komuniteti vleror që quhet Europë.
- c. Nxitjen e iniciativave për problemet në fushat e historisë, kulturës, si dhe përfaqësimin si institucion i specializuar, (duke pasur në përbërje të vet ekspertë historianë, arkeologë, gjuhëtarë, etnokulturorë, ekonomist, inxhinierë), të interesave të qytetarëve për këto çështje në proceset vendimmarrëse dhe në instancat gjyqësore në mbrojtje të interesit publik e kombëtar në dobi të Shkollave, të Arsimit, Metodave studimore, duke ringritur debatin e munguar shkencor në këto fusha për zbulimin e se Vërtetës.
- d. Synimin për të ndërgjegjesuar shqipëtarë-arbërit kudo që ndodhen, për rëndësinë e njohjes së origjinës sonë, për të kuptuar peshën e kësaj vlere historike në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, për të marrë përsipër përgjegjësinë e kësaj peshe si trashëguesit dhe mbartësit themelor e të drejtpërdrejtë të tyre.
- e. Rritja e vetëdijes së shqiptarëve mbi rëndësinë e njohjes së lidhjeve të historisë së tyre me kulturat e antikitetit.

***Fusha e aktiviteteteve të Fondacionit "Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona" do të përfshijë:***

1. Edukimin, sensibilizimin dhe nxitjen e kërkimeve dhe studimeve në fushat që përfshin shkenca e Albanologjisë.
2. Përhapjen e të dhënave shkencore që lidhen me pasqyrimin dhe trajtimet mbi Kombin tonë që nga paraantikiteti deri në ditët e sotme, në media dhe Shoqatat mbare-shqiptare.
3. Bashkëpunimin me Institucionet Akademike (shqiptare dhe të huaja), duke shfrytëzuar metodën e munguar-ate të debatit të hapur mbi disa nga tezat që janë në përdorim në shkencën Albanologjike dhe prurjet e reja të studiuesve profesioniste dhe autodidaktë.



4. Mbështetjen aktive të studimeve afatshkurtra dhe afatgjata që i mbulon shoqata “Rrenjët tona”, që do të kryhen në hapësirën territoriale të Republikës së Shqipërisë dhe më gjerë, në zbatim të Konventave Kombëtare e Ndërkombëtare.
5. Mbrojtjen e iniciativave për problemet në fushat e historisë, kulturës, si dhe përfaqësimin si institucion i specializuar, të interesave të qytetarëve për këto çështje në proceset vendimmarrëse dhe në instancat gjyqësore në mbrojtje të interesit publik e kombëtar.

Objektivat e lartë përmendura të fondacionit mund të pasurohen me vendim të Bordi Drejtues.

## KREU II STRUKTURA ORGANIKE E FONDACIONIT

### Neni 7

#### *Organet Drejtuese*

Fondacioni funksionon si rrjet mbarëkombëtar e më gjerë i shumë shoqatave historike, gjuhësore dhe etnokulturore.

Organet drejtuese të Fondacionit:

1. Drejtori Ekzekutiv
2. Bordi Drejtues, organi më i lartë vendimmarrës;

### Neni - 8

#### *Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit*

1. Drejtori Ekzekutiv ka kompetencën për tu marrë me aktivitetin e përditshëm të fondacionit dhe zbatimin e programeve të përcaktuara nga Bordi Drejtues, si edhe me kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të deleguar prej Bordit Drejtues.
2. Drejtori Ekzekutiv qëndron në detyrë për një afat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.
3. Në momentin e themelimit të fondacionit Drejtori Ekzekutiv emërohet: z. Sazan *GURI*, atesia Ilmi, lindur me 11.12.1956 ne Berat dhe banues në Tirane, madhor, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta ID me nr. personal F612110530.

### Neni 9

#### *Bordi drejtues*

- 1) Bordi Drejtues përbëhet nga një numër prej 5 (pesë) antarësh, persona fizik. Përbërja e antareve dhe emërimi i tyre vendoset me Statut.



- 2) Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të tyre, sipas parashikimeve të Statutit.
- 3) Bordi Drejtues vendos rreth çdo argumenti ose lënde sipas Statutit dhe/ose ligjit.

Në momentin e themelimit të fondacionit, Bordi Drejtues përbëhet nga: Dr.Stefan PINGULI, ing.Fred BALAJ, Fatbardha DEMI, ing. Anastas SHUKE, prof. asc. av. Astrit MEMIA

## **Neni 10**

### ***Themeluesit***

Themeluesit e fondacionit “Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona” janë:

Z. Sazan Guri, atesia Ilmi, lindur me 11.12.1956 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F612110530.

Z. Stefan Pinguli, atesia Dhimiter, lindur me 27.12.1953 ne Tiranedhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F31227042L

Z. Frederik Balaj, atesia Ali, lindur me 26.12.1960 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal G01226034N.

## **Neni 11**

### ***Pasuria***

1) Pasuria e fondacionit përbëhet nga kontributet e të tretëve persona fizik apo juridik, nga kontributet ose subvensionet e enteve publike ose private, nga dhurimet, nga të ardhurat që vijnë si rezultat i aktivitetit të fondacionit ose nga aktivitete të tjera të ngjashme apo të lidhura, si dhe nga përfitimet, me çdo mënyrë të ligjshme, të pasurive të luajtshme, të paluajtshme, si dhe nga burime të tjera.

2) Çdo përfitim, me çdo mënyrë të ligjshme, i pasurive të luajtshme, të paluajtshme, si dhe të mirave të tjera prej fondacionit, nuk mund të përbëjë objekt të personave themelues dhe në asnjë rast nuk mund të pretendohen nga këta të fundit ose trashëgimtarët e tyre, gjatë ekzistencës së fondacionit ose në rast mbarimi, shpërndarje ose likudimi për çfarëdo lloj arsye të Fondacionit.

3) Në momentin e themelimit, pasuria e fondacionit përbëhet nga një shumë prej 100.000 Lekë.

## **NENI 12**

### ***Te drejtat e perfaqesimit dhe firmes***

1) Drejtori Ekzekutiv ka të drejtën për të përfaqësuar fondacionin përpara të tretëve dhe në gjykim, si dhe të drejtën për të firmosur çdo akt që ka të bëjë me administrimin, në emër të fondacionit, mbas aprovimit dhe konsultimit me Bordin drejtues në të gjithë territorin kombëtar dhe jashtë tij.



2) Në kuadrin e kompetencave të tij, Drejtori Ekzekutiv mund t'i delegojë të tretëve përmbushjen e disa akteve specifike ose kategori aktesh në emër të Fondacionit.

3) Drejtori Ekzekutiv, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tij, ngarkohet me detyrën për të kryer të gjitha procedurat pranë zyrave kompetente me qëllim regjistrimin e fondacionit.

### **NENI 13**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

- 1) Për gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Akt Themelimi, zbatohen dispozitat e Kodit Civil Shqiptar, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe Ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.
- 2) Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (kater) kopje në gjuhën shqipe.

\* \* \* \* \*

Unë, Noterja ia lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë palëve, të cilat e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Akt Themelimi nënshkruhet lirisht nga palët në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

**THEMELUESIT**

Prof. Asc. Av. Sazan **GURI**

Dr. Stefan **PINGULI**

ing. Frederik **BALAJ**

“RRËNJËT TONA”



## STATUT

### I FONDACIONIT RRËNJËT TONA

Sot me datën \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019 zyren e Noterise Tirane, perpara meje Noteres Mimoza Shehu, Notere e Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne adrese Rruga « Abdyl Frasheri » Pll.3.3 u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte :

Z. Sazan **Guri**, atësia Ilmi, lindur me 11.12.1956 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F61211053O.

Z. Stefan **Pinguli**, atësia Dhimiter, lindur me 27.12.1953 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F31227042L

Z. Frederik **Balaj**, atësia Ali, lindur me 26.12.1960 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal G01226034N.

të cilët bien dakord për sa më poshtë:

#### Neni 1

##### *Emri dhe statusi juridik i Fondacionit*

- f) Emërtimi i fondacionit është “*Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona*”
- g) FONDACIONI ‘Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona’ do të përdori si simbol identifikues shkurtimin e emrit të saj në gjuhën shqipe, “ARRT”
- h) QKRRT zhvillon aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- i) QKRRT ka stemën dhe vulën e saj. Stema dhe vula përdoret vetëm nga personat e autorizuar.
- j) QKRRT është një organizatë akademiko-social-kulturore, institucion i specializuar, jo-qeveritare, jo-politike, jo-fitimprurëse dhe pa anëtarësi.

#### Neni 2

*Selia* për **Fondacionin** “Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona - ARRT” ndodhet në Tiranë, Rr.Zef Jubani, Pall. Bjorn, Ap. 62, k-8, Tiranë, Shqipëri.

#### Neni 3

##### *Stema e fondacionit*

Si stemë e ARRT do të jetë: Shqiponja e stilizuar me bririn e dhisë amalthea e Skënderbeut

#### Neni 4



### ***Kohëzgjatja***

Fondacioni do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar,

### **Neni 5**

#### **Metoda e veprimtarisë së Fondacionit**

- a) Puna dhe veprimtaria e fondacionit është e hapur për publikun.
- b) Transparenca e veprimtarive sigurohet me përgatitjen e raporteve të rregullta mbi punën e grupimit, si dhe publikimin e tyre në një web-site të fondacionit
- c) Qëllimi i Fondacionit është që të ngrejë një "INSTITUCION TË SPECIALIZUAR", të emërtuar Akademia Shkencore Alternative "RRËNJËT TONA", veprimtaria e së cilës do të përfshijë parashtrimin dhe rishikimin e fakteve historike, gjuhësore dhe etnokulturore të hulumtuara deri më sot dhe prurjet e reja nga studiues të ndryshëm, mbi vijëmsinë e shqipes së sotme nga gjuhët e lashtësisë, aotoktoninë në trevat e tyre dhe vazhdimësinë e pandërprerë të historisë sonë, si dhe t'iu tregojë shqiptarëve faktet shkencore të qëniers si banorë e si popull natyral të europës së lashtë.

### **Neni 6**

#### **Objekti i Veprimtarisë së Fondacionit**

Veprimtaria e fondacionit 'Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona' do të përqëndrohet në këto fusha:

1. Historiografi, Gjuhësi, Etnokulturë, Ekonomi patriotike, Turizëm historik dhe Inxhinieri dhe degë të tjera që lidhen me shkencën Albanologjike, për të cilat do të ketë departamente më vete operimi dhe pune, me qëllim informimin dhe vënien në dispozicion të subjekteve të ndryshëm shteterorë e privatë, të publikut të gjerë, vendas e të huaj e të organeve të pushtetit qendror e lokal, studime, projekte dhe konsulta në fushat e mësipërme që do t'iu shërbejnë atyre për të hartuar programe zhvillimi afatshkurtëra, afatmesëm e afatgjata.
2. Fondacioni, si Institucion i specializuar me departamentet e saj, e organizuar në nivel Akademie Alternative do të sjellë fakte e interpretime, sesi mund të ndihmojë historia për të siguruar lirinë e vërtetë të mendimit dhe të shprehjes dhe të bëhemi pjesë dinjitoze e komuniteti vleror që quhet Europë.
3. Nxitjen e iniciativave për problemet në fushat e historisë, kulturës, si dhe përfaqësimin si INSTITUCION I SPECIALIZUAR, (duke pasur në përbërje të vet ekspertë historianë, arkeologë, gjuhëtarë, etnokulturorë, ekonomist, inxhinierë), të interesave të qytetarëve për këto çështje në proceset vendimmarrëse dhe në instancat gjyqësore në mbrojtje të interesit publik e





kombëtar në dobi të Shkollave, të Arsimit, Metodave studimore, duke ringritur debatin e munguar shkencor në keto fusha për zbulimin e se Vërtetës.

4. Synimin për të ndërgjegjesuar shqipëtarë-arbërit kudo që ndodhen, për rëndësinë e njohjes së origjinës sonë, për të kuptuar peshën e kësaj vlere historike në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, për të marrë përsipër përgjegjësinë e kësaj peshe si trashëguesit dhe mbartësit themelor e të drejtpërdrejtë të tyre.
5. Rritja e vetëdijes së shqiptarëve mbi rëndësinë e njohjes së lidhjeve të historisë së tyre me kulturat e antikitetit.

***Fusha e aktiviteteteve të fondacionit “Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona” do të përfshijë:***

1. Edukimin, sensibilizimin dhe nxitjen e kerkimeve dhe studimeve në fushat që përfshijn shkenca e Albanologjisë.
2. Përhapjen e të dhënave shkencore që lidhen me pasqyrimin dhe trajtimet mbi Kombin tonë që nga paraantikiteti deri në ditët e sotme, në media dhe Shoqatat mbare-shqiptare.
3. Bashkëpunimin me Institucionet Akademike (shqiptare dhe të huaja), duke shfrytëzuar metodën e munguar – atë të debatit të hapur mbi disa nga tezat që janë në përdorim në shkencën Albanologjike dhe prurjet e reja të studiuesve profesioniste dhe autodidaktë.
4. Mbështetjen aktive të studimeve afatshkurtra dhe afatgjata që i mbulon shoqata “Rrënjët tona”, që do të kryhen në hapësirën territoriale të Republikës së Shqipërisë dhe më gjerë, në zbatim të Konventave Kombëtare e Ndërkombëtare.
5. Të ushtrojë të gjitha keto veprimtari, si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur apo plotësuese me veprimtaritë e mësipërme në përputhje me nenet e këtij statuti.
6. Mbrojtjen e iniciativave për problemet në fushat e historisë, kulturës, si dhe përfaqësimin si institucion i specializuar, të interesave të qytetarëve për këto çështje në proceset vendimmarrëse dhe në instancat gjyqësore në mbrojtje të interesit publik e kombëtar.

Objektivat e lartë përmendura të fondacionit mund të pasurohen me vendim të Bordi Drejtues.

## **NENI 7**

### ***Pasuria***

1) Pasuria e fondacionit përbëhet nga kontributet e të tretëve persona fizik apo juridik, nga kontributet ose subvencionet e enteve publike ose private, nga dhurimet, nga të ardhurat që vijnë si rezultat i aktivitetit të fondacionit ose nga aktivitete të tjera të ngjashme apo të lidhura, si dhe nga përfitimet, me çdo mënyrë të ligjshme, të pasurive të luajtshme, të palujtshme sidhe nga burime të tjera.



2) Çdo përfitim, me çdo mënyrë të ligjshme, i pasurive të luajshme, të paluajshme sidhe të mirave të tjera prej fondacionit , nuk mund të përbëjë objekt të personave themelues dhe në asnjë rast nuk mund të pretendohen nga këta të fundit ose trashëgimtarët e tyre, gjatë ekzistencës së fondacionit ose në rast mbarimi, shpërndarje ose likudimi për çfarëdo lloj arsye të fondacionit

3) Në momentin e themelimit, pasuria e fondacionit përbëhet nga pasuria e përshkruar në Aktin e Themelimit.

## **Neni 8**

### ***Themeluesit***

Themeluesit e fondacionit “**Akademia Alternative Shkencore Rrënjët Tona**” janë:

Z. Sazan Guri, atësia Ilmi, lindur me 11.12.1956 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi te plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F612110530.

Z. Stefan Pinguli, atësia Dhimiter, lindur me 27.12.1953 ne Tiranedhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F31227042L

Z. Frederik Balaj, atësia Ali, lindur me 26.12.1960 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal G01226034N.

## **Neni 9**

### ***Organet e fondacionit***

Organet e Fondacionit janë:

- a) Drejtori Ekzekutiv.
- b) Bordi Drejtues;

## **Neni 10**

### ***Bordi drejtues , përbërja, kompetencat***

- a) Bordi Drejtues përbëhet nga një numër prej 5 (pesë) antarësh, persona fizik. Përbërja e Bordit drejtues dhe mënyra e emërimit të tyre vendoset me Statut. Pas nënshkrimit të këtij Statuti, përbërja e Bordit Drejtues, shkarkimi dhe emërimi i këshilltarëve vendoset nga themeluesit me shumicë absolute.
- b) Në rastin e shkarkimit nga detyra të të gjithë antareve çdo i interesuar mund të kërkojë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë marrjen e masave për të mundësuar vazhdimin e aktivitetit të fondacionit dhe nëse është mundësia, emërimin e një Bordi te ri drejtues ose shpërndarjen e fondacionit.



- c) Detyra e antarëve të Bordit drejtues dhe çdo pozicion tjetër i zgjedhur kryhet pa shpërblim. Bordi Drejtues mund të vendosë për rimbursimin e shpenzimeve të autorizuara dhe të dokumentuara të çdo antari gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.
- d) Është e detyrueshme që njëri prej anëtarëve të Bordit Drejtues të jetë jurist, anëtar i Dhomës së Avokatisë së Republikës së Shqipërisë.
- e) Bordi drejtues administron punët organizative dhe ato shkencore, me anë të një Këshilli Shkencor, i përbërë nga përfaqësues të Departamenteve shkencore që automatikisht është drejtuesi i departamentit, dhe ndonje antar i tij, me grade shkencore doktor e lart, si nga departamenti Historia, Gjuhësia, Etnokultura, Inxhinieria dhe Patriotizmi ekonoimik, me përbërje ekspertë, pedagogë e profesorë dhe akademikë të fushave përkatëse.
- f) Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të tyre, sipas parashikimeve të këtij statuti.
- 3) Bordi Drejtues vendos për:
- ndryshimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të fondacionit me shumicën e thjeshtë të antareve;
  - përcaktimin e fushave dhe programeve të aktivitetit të fondacionit;
  - rregullat e zbatimit të programeve që përmenden më sipër;
  - kriteret e administrimit të pasurisë dhe çështjet e tjera ekonomike e financiare të administrimit të fondacionit dhe pasurisë së saj;
  - miratimin vjetor të bilancit paraprak dhe përfundimtar të vitit, përgatitur nga Organi Ekzekutiv;
  - emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues që vijnë në këtë detyrë pas antareve të emëruar për herë të parë sipas Aktit të Themelimit;
  - rimbursimin e shpenzimeve për antaret;
  - emërimin e Drejtorit Ekzekutiv dhe përcakton shpërblimin ndaj tij;
  - miratimin e programit të aktivitetit të propozuar nga Organi Ekzekutiv;
  - emërimin e përfaqësuesve të posaçëm dhe delegimin e kompetencave përkatëse;
  - shpërndarjen dhe likuidimin e fondacionit;
  - delegimin e kompetencave të posaçme Organit Ekzekutiv;
  - vendos mbi blerjen e pasurive të paluajtshme të fondacionit, si dhe shitjen apo tjetërsimin e tyre; dhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara në Statut dhe në ligj.
- 4) Në momentin e themelimit të Fondacionit, Bordi Drejtues përbëhet nga personat e treguar në Aktin e Themelimit dhe këtë statut.

### ***Përbërja e Bordit Drejtues***

- Bordi Drejtues ka fillimisht 5 (pesë) anëtarë me të drejta të plota, të cilët gëzojnë të drejtën e votës.



- b. Bordi drejtues formon trupën shkencore me dy përfaqësues për çdo departament (Histori, Gjuhësi, Etnokulturë, Inxhinieri dhe Patriotizëm Ekonomik), e quajtur Këshilli Shkencor.
- c. Anëtarët e Këshillit Shkencor të Qendrës zgjidhen nga mbledhja e parë e Bordit Drejtues dhe presupuzohet që çdo departament do të ketë dy përfaqësues në këtë Këshill.
- d. Anëtarët e Këshillit Shkencor të Qendrës në çdo rast mund të marrin kompetenca të caktuara ekzekutive me vendim të Bordit Drejtues.

## Neni 11

### ***Bordi drejtues, mënyra e thirrjes dhe mbajtjes së mbledhjeve të tij***

- 1) Mbledhjet e Bordit drejtues thirren rregullisht nga Drejtori Ekzekutiv, me iniciativën e tij ose me kërkesën e shumicës së antareve në selinë ligjore apo në ndonjë vend tjetër.
- 2) Drejtori Ekzekutiv cakton rendin e ditës, duke respektuar thelbin e kërkesave për thirjen e mbledhjes.
- 3) Bordi Drejtues mblidhet në selinë e fondacionit ose vend tjetër të paktën dy herë në vit.
- 4) Lajmërimi për thirrjen e mbledhjes do t'iu komunikohet antareve me shkrim nëpërmjet postës rekomande ose faks ose postës elektronike, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes.
- 5) Në thirrjen e tij të parë, Bordi drejtues konsiderohet si rregullisht i mbledhur, nëse ekziston shumica absolute e antareve të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë nga ndonjë antar tjetër. Në thirrjen e tij të dytë, Bordi drejtues konsiderohet si rregullisht i mbledhur cilido qoftë numri i antareve të pranishëm apo të përfaqësuar. Çdo antar nuk mund të mbartë më shumë se dy përfaqësime.
- 6) Kryesimi i mbledhjes do të mbahet nga një antar posaçërisht i emëruar nga Bordi Drejtues, si Kryetar i mbledhjes.
- 7) Bordi drejtues do të konsiderohet rregullisht i mbledhur me praninë e shumicës së antareve dhe do të vendosë me votën e shumicës të të pranishmëve, që i bie tre persona nga pesë antarë që ai ka përfshirë. Por për konsulencë mund të ketë edhe persona nga jashtë shqipërisë që mund të komunikojnë me skajp apo video konferencë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe nga Statuti ose ligji. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit të mbledhjes është përcaktuese.
- 8) Bordi drejtues mendohet i thirrur rregullisht, edhe në rastet kur nuk zbatohen formalitetet e kërkuara sa më sipër, në qoftë se janë të pranishëm të gjithë antaret.

### ***Kryetari i Bordit***



- a. Kryetari i Bordit zgjidhet me votë të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë votash, me të drejtë rizgjedhje, jo më shumë se dy herë.
- b. Mandati i Kryetarit të Bordit është katër vjet kalendarik. Mandati i parë i Kryetarit të Bordit fillon në momentin e regjistrimit të Fondacionit në Gjykatë.
- c. Kryetari i Bordit administron, udhëheq dhe drejton Fondacionin për realizimin e qëllimeve të saj.
- d. Kryetar i bordit drejtues do te jete: z. Stefan PINGULI

### ***Në mënyrë të veçantë:***

1. Pret dhe diskuton vërejtjet, propozimet dhe kërkesat e formuluar nga anëtarët e Bordit Drejtues;
2. Thërret mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve të Bordit Drejtues;
3. Propozon dhe ndërmerr iniciativa promovuese për realizimin e qëllimeve institucionale të Qendrës;
4. Kryen të gjitha detyrat në lidhje me organizimin e brendshëm, administrimin dhe drejtimin e Qendrës;
5. U jep anëtarëve dhe konsulentëve të jashtëm detyra të përkohshme, emërimet e përfaqësime.
6. Krijimin e organeve të tjera ekzekutive ose këshillimore me miratim edhe të bordit.
7. Ndërmerr iniciativa dhe të vendos për çështje të tjera që nuk janë në kundërshtim me Statutin dhe parashikohen në ligj.
8. Të mbikëqyrë, kontrollojë dhe zbatojë politikën dhe objektivat e Qendrës.

### **Neni 12**

#### ***Mbarimi i detyrës së antarit***

- 1) Anëtarësia në Bordin Drejtues mbaron:
  - a) me dorëheqjen e paraqitur me shkrim;
  - b) me përjashtim, nëpërmjet një vendimi të Bordit Drejtues ; dhe
  - c) me vdekjen e antarit.
- 2) Përjashtimi i antarit do të vendoset nga Bordi Drejtues me shumicën e posaçme, të parashikuar për ndryshimet në Statut. Në çdo rast, i interesuari duhet të njoftohet dhe ftohet nga Bordi Drejtues për të dhënë shpjegimet përkatëse në mbledhjen e bordit që do të shqyrtojë propozimin për shkarkimin e tij.
- 3) Në rast të një kërkesë padie për përgjegjësi të mundshme ndaj një anëtarit të Bordit Drejtues, detyra e antarit do të pezullohet me një vendim po të Bordit Drejtues për të gjithë kohëzgjatjen e padisë në fjalë.



4) Në rastin e mbarimit të detyrës të ndonjë antari, Bordi Drejtues ka të drejtë të kooptojë zëvendësin. Anëtari i emëruar në këtë mënyrë do të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e antarit të ri nga Bordi Drejtues.

### **Neni 13**

#### ***Drejtori ekzekutiv, kompetencat***

1) Aktiviteti i përditshëm i fondacionit drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv. Mënyra e emërimit të tij përcaktohet me Statut. Pas nënshkrimit të këtij Statuti, shkarkimi dhe emërimi i Drejtori Ekzekutiv vendoset nga Bordi Drejtues, duke ndjekur procedurat dhe me shumicën e votave të kërkuar për ndryshimin e Statutit. Detyra e Drejtorit Ekzekutiv mund të shpërblehet me vendim të Bordit Drejtues.

2) Drejtori Ekzekutiv qëndron në detyrë për një afat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

3) Në momentin e themelimit të fondacionit Drejtori Ekzekutiv emërohet:

- z.Sazan **Guri**, atesia Ilmi, lindur me 11.12.1956 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga karta ID me nr personal F612110530.

4) Drejtori Ekzekutiv ka kompetencën për tu marrë me aktivitetin e përditshëm të fondacionit dhe zbatimin e programeve të përcaktuara nga Bordi Drejtues si edhe me kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të deleguar nga Bordi Drejtues apo që nuk i delegohet këtij të fundit as nga ligji as nga Akti i Themelimit apo Statuti.

Pa u kufizuar vetëm përsa më poshtë, Drejtori Ekzekutiv:

- (a) mbikqyr dhe kujdeset për administrimin financiar dhe pasuror të Fondacionit;
- (b) harton dhe miraton rregulloret;
- (c) konsultohet dhe më pas vendos se mund të krijojë komitete të posaçme, duke nxjerrë edhe rregullore përkatëse që përcaktojnë funksionet dhe kohëzgjatjen e tyre;
- (d) konsultohet dhe më pas vendos për punësimin dhe shkarkimin e personelit dhe përcakton trajtimin juridik dhe ekonomik i cili do të rregullohet nga dispozitat ligjore në fuqi;
- (e) konsultohet dhe më pas vendos mbi pranimin e kontributeve, financimeve, dhurimeve dhe trashëgimitë në favor të fondacionit;
- (f) konsultohet dhe më pas vendos mbi destinimin e shumave të arkëtuara;
- (g) konsultohet dhe më pas vendos mbi blerjen e pasurive të luajtshme duke përcaktuar edhe destinacionin e tyre; dhe
- (h) konsultohet dhe më pas vendos mbi transferimet, shitjet dhe çdo akt tjetër tjetërsimi të pasurive që përbëjnë pjesë të pasurisë se luajtshme të fondacionit



## Neni 14

### E drejta e përfaqësimit

- 1) Drejtori Ekzekutiv ka të drejtën për të përfaqësuar fondacionin përpara të tretëve dhe në gjykim, si dhe të drejtën për të firmosur çdo akt që ka të bëjë me administrimin, në emër të fondacionit, në të gjithë territorin kombëtar dhe jashtë tij.
- 2) Në kuadrin e kompetencave të tij, Drejtori Ekzekutiv mund t'iu delegojë të tretëve përmbushjen e disa akteve specifike ose kategori aktesh në emër të fondacionit.

## Neni 15

### Aparati Administrativ i Fondacionit

- a. Struktura e Aparatit Administrativ të fondacionit është e përbërë në drejtori Shkencore dhe Organizative, kompetencat e të cilave përcaktohen me vendim të Bordit Drejtues.
- b. Krijimi dhe shkrirja e Drejtorive dhe struktura e tyre caktohet me propozim të Kryetarit të Bordit dhe miratimin e Bordit Drejtues.
- c. Drejtorët e Departamenteve Shkencore dhe Organizative caktohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Bordit të Fondacionit
- d. Drejtoritë Shkencore dhe Organizative përgjigjen përpara Kryetarit të Bordit nëpërmjet një raporti të shkruar mbi ecurinë e punës.
- e. Sekretari i Përgjithshëm kontrollon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Drejtorive Shkencore dhe Organizative.
- f. Sekretari i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit të Drejtorisë përkatëse cakton dhe shkarkon stafin përbërës të drejtorisë.
- g. Veprimtaria e brendshme e Drejtorive Shkencore dhe Organizative, realizohet në përputhje me dispozitat e Kodin të Punës, marrëdhëniet midis Qendrës dhe anëtarëve të stafit rregullohet në bazë të Kontratës së Individuale të Punës.
- h. Çdo person që ka mbaruar arsimin e lartë ka të drejtë të jetë pjesë e Aparatit Administrativ të fondacionit.

## Neni 16

### Komiteti Shkencor

- a. Komiteti Shkencor, është një organ veprues pranë Kryetarit të Bordit dhe Bordit Drejtues.
- b. Anëtarët e Komitetit Shkencor janë persona fizik të shquar në fushën e shkencës.
- c. Komiteti Shkencor përbëhet nga aq anëtar sa shoqata pjesëmarrëse ka, të cilët caktohen me propozimin e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe me miratimin e shumicës absolute të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Bordit Drejtues.



- d. Komitetit Shkencor i Qendrës përbën organin shkencor kryesor, që shqyrton dhe përcakton problematikat, fushën studimore shkencore gjithashtu dhe analizon dhe jep mendim për programet dhe strategjinë e Qendrës.
- e. Komiteti Shkencor ka të drejtë që të jetë i pranishëm gjatë mbledhjes së Bordit Drejtues, dhe të parashtrijë mendimet e tyre mbi çështjet objekt diskutimi.
- f. Kryetari i Komitetit Shkencor zgjidhet nga 3/4 e anëtarëve të Këshillit Shkencor.
- g. Komiteti Shkencor përcakton në mënyrë të pavarur veprimtarinë e tij shkencore, ai nuk ka të drejtë të përfaqësojë Qendrën tek të tretët, vecse në raste të aprovuara nga Bordi Drejtues.
- h. Mandati i anëtarëve të Komitetit Shkencor është i përhershëm, mandati i Kryetarit të Këshillit shkencor është katër vjeçar.
- i. Anëtarët e Komitetit Shkencor përjashtohen vetëm në rastet, kur shkelin Statutin e Qendrës dhe Ligjet në Republikën e Shqipërisë, në të tilla raste Bordi Drejtues merr vendim me shumicë absolute.

## **Neni 16**

### ***Bilanci dhe kontabiliteti***

- 1) Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 2) Bordi Drejtues do të hartojë bilancin e vitit ushtrimor dhe do t'ia paraqesi për miratim Bordit brenda 31 marsit të vitit pasardhës.

## **Neni 17**

### ***Shpërndarja e fondacionit***

- 1) Shpërndarja e fondacionit vendoset nga Bordi drejtues me shumicën që kërkohet për ndryshimin e Statutit.
- 2) Në rast shpërndarje, Bordi Drejtues me vendimin cituar në pikën 1) më lart, përcakton mënyrat dhe destinacionet e mundshme të pasurisë neto të fondacionit pas pagesës së të gjithë detyrimeve të mundshme, gjithësesi duke respektuar qëllimin e fondacionit. Për këtë qëllim, Bordi Drejtues mund të emërojë një ose disa likuidatorë, duke përcaktuar të drejtat dhe numrin e tyre.

## **Neni 18**

### ***Dispozita të fundit***

- 1) Për gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" dhe Ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".
- 2) Ky Statut është hartuar në 4 (kater) kopje në gjuhën shqipe.

\* \* \* \* \*





Unë, Noterja ia lexova këtë Statut me zë të lartë palëve, të cilat e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Statut nënshkruhet lirisht nga palët në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

### THEMELUESIT

Prof.inxh. Sazan **GURI**

Dr.inxh. Stefan **PINGULI**

inxh.dipl. Fred **BALAJ**



# “RRËNJËT TONA”